

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore te Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

NR I VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/A/128/2011
26/10/2011

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

- (1) Në secilën prej dyzetë e shtatë (47) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe C të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë;
- (2) Në secilën prej shtatëmbëdhjetë (17) kërkesave të identifikuara në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet; dhe
- (3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët B dhe D të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposëdim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposëdim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksat e saj,

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e pestë nga 24 deri 26 tetor 2011 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 2,261 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e njëzetë e pestë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Dy kërkesa kontestuese për pronë bujqësore të cilat iu paraqitën Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive iu kthyen Sekretarisë nga Komisioni për verifikim të mëtejshëm. Gjithsej 2,259 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 64 kërkesat e identifikuar në listën e bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 2,195 kërkesash për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në vendimet e tjera, pikërisht vendimin KPCC/D/A/126/2011 dhe KPCC/D/A/127/2011.

9. Gjithsej 63 kërkesa të përfshira në këtë vendim nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndonëse një kërkesë (Kërkesa nr. 15123) ishte subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këtë kërkesë është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të gabimeve të tjera të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, kjo kërkesa duhet të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar. Asnjë palë përgjegjëse në këtë kërkesë ose uzurpues i pronës nuk janë paraqitur për këtë kërkesë. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar atë për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës si dhe autoritetet kadastrave përkatëse janë informuar se vendimi i mëparshëm të Komisionit është pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose

Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksin e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislativë dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksin I, II dhe III, respektivisht.

rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

11. Të 54 kërkesat e shënuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose një palë që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, secilës prej palëve përgjegjëse i është dorëzuar një kopje e kërkesës të parashtruar nga paraqitësi përkatës i kërkesës. Në bazë të nenit 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësve të kërkesave u është dorëzuar një kopje e dokumenteve të parashtruara nga palët respektive përgjegjëse në kërkesë. Të dy palëve, në secilën rast, u është dhënë mundësia të komentojnë për informacionin e ofruar nga pala tjetër, edhe komentet apo informacioni i tillë është marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes të kërkesës.

12. Të 10 kërkesat e shënuara në pjesën C dhe D të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë.

13. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë

14. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

15. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.)

16. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për pronën e kërkuar.

17. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

1. *Humbje e posedimit jo për shkak të konfliktit.*

18. Kërkesa nr. 00042 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon riposedimin e pronës së kërkuar dhe thekson se e ka humbur posedimin e një pjese të pronës në vitin 2003-2004 kur pala përgjegjëse e uzurpoi atë dhe ndërtoi shtëpinë në tokë pa lejen e paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës ka iniciuar procedurë gjyqësore kundër palës përgjegjëse për të hequr ndërtimet e paligjshme të palës përgjegjëse nga prona e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pranon se ai nuk e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar si pasojë e konfliktit të viteve 1998-1999.

19. Kërkesa nr. 00237 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, pra djalit të tij. Djali i paraqitësit të kërkesës është bashkëpronar i pronës së kërkuar në bazë të një kontratë blerje të bërë në shtator 1999. Paraqitësi i kërkesës dhe pala përgjegjëse, i cili është uzurpuesi aktual i pronës së kërkuar, konfirmojnë se prona e kërkuar nuk është ndarë

në mesin e bashkëpronarëve. Paraqitësi i kërkesës nuk kërkon konfirmim i pronësisë ose riposëdimin, por thjesht kërkon ndarjen e pronës në pjesët përkatëse ideale për bashkëpronarët. Paraqitësi i kërkesës pranon se as ai dhe as djali i tij nuk e kanë humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i konfliktit të vitit 1998-99.

20. Kërkesa nr. 06328 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës të tij, paraqitësi i kërkesës ka ofruar një numër dokumentesh, duke përfshirë fletën poseduese e cila dëshmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës për parcelën e kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se shkoi në Krushevc në Serbi në vitin 1997 e kjo është koha kur ai ndërpreu shfrytëzimin e pronës së kërkuar. Në këto rrethana, ku paraqitësi i kërkesës ka humbur posedimin në vitin 1997, kur ai u transferua në Krushevc të Serbisë, Komisioni konstaton se humbja e posedimit të pronës së kërkuar nga paraqitësi i kërkesës nuk ka të bëjë me rrethanat që rezultuan nga konflikti i vitit 1998-99. Kështu kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

21. Kërkesa nr. 00889 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka ofruar fletën poseduese të datës 8 shtator 2008. Megjithatë, ky dokument tregon se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të Zyrës së Pyjeve "Radusha". Paraqitësi i kërkesës pohon se prona është transferuar nga babai i tij në pronësi të Zyrës së Pyjeve në vitin 1955. Babai i tij e ka humbur posedimin në këtë kohë. Humbja e posedimit të pronës së kërkuar nga paraqitësi i kërkesës nuk është rezultat i rrethanave që lidhen direkt, ose që rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-99. Kështu kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

22. Kërkesa nr. 11721 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposëdimin e pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pretendon se prona u uzurpua nga pala përgjegjëse në vitin 1992, pa lejen e paraqitësit të kërkesës dhe ai nuk ka pasur posedimin e saj që atëherë. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se është në vazhdim një procedurë gjyqësore për pronën e kërkuar, e cila ka filluar në vitin 1992. Përfaqësuesi i autorizuar i palës përgjegjëse deklaroi se prona e kërkuar iu konfiskua palës përgjegjëse në vitin 1953 dhe se palës përgjegjëse iu kthyen të drejtat pronësore në vitin 1993. Në këto rrethana është e qartë se humbja e pretenduar e paraqitësit të kërkesës nuk ka lidhje dhe as që rezulton nga konflikti i armatosur në vitet 1998-1999.

23. Kërkesat nr. 51808, 51811 dhe 51812 janë depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës, bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës fillimisht kërkoi konfirmimin e së drejtës pronësore, por më pas konfirmoi se i ka humbur pronat e kërkuara si rezultat i shpronësimit dhe se ai ishte kompensuar për humbjen. Prona e kërkuar është e uzurpuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Përfaqësuesi i autorizuar i palës përgjegjëse deklaroi se prona e kërkuar i takon palës përgjegjëse dhe ka depozituar një Certifikatë për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme në mbështetje të pretendimeve të tij. Ky dokument tregon se parcelat e kërkuara me të vërtetë janë të regjistruara në emër të palës përgjegjëse. Ai ka depozituar edhe një kopje të vendimit të shpronësimit të marrë më 5 mars 1984 nga organi përkatës i Kuvendit Komunal të Prishtinës. Në këto rrethana duhet të konsiderohet se paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se humbja e pretenduar nuk ndërlidhet e as nuk rezulton nga konflikti i armatosur në vitet 1998-1999.

2. Tjetërsimi vullnetar ose aftësia për të ushtruar të drejtën pronësore.

24. Kërkesa nr. 27409 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pra nipit/mbesës të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse, i cili është aktualisht ka uzurpuar pronën e kërkuar, pohon se e ka blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2008. Pala përgjegjëse deklaron se kontrata e blerjes është vërtetuar në gjykatë dhe se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të djalit të tij në kadastër. I përballur me pretendimet e palës përgjegjëse, paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se ia ka shitur pronën palës përgjegjëse në vitin 2007 dhe konfirmon se ai nuk kërkon më të drejtë ligjore për pronën. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

25. Kërkesa nr. 40100 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pra i biri, i bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse e cila është uzurpuesi aktual i pronës së kërkuar, deklaron se nëna e paraqitësit të kërkesës ia ka të shitur atij pronën në vitin 2000. Kur paraqitësit të kërkesës iu dha deklarata e palës përgjegjëse, ai konfirmoi se nëna e tij ia kishte shitur pronën palës përgjegjëse në vitin 2000. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

26. Kërkesa nr. 51723 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare pra i biri i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse, i cili aktualisht ka uzurpuar pronën e kërkuar, deklaron se ai e bleu pronën nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2005 ose 2006.. Paraqitësi i kërkesës e ka pranuar shitjen, por nuk e tërhoqi kërkesën.

27. Kërkesat nr. 51761, 51764, 51765, 51771 dhe 51772 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pra bashkëshortes të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Fillimisht paraqitësi i kërkesës kërkoi riposedimin e pronës së kërkuar, megjithatë më vonë konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur dhe se ai do të tërhiqte kërkesën, megjithatë ai dështoi ta bënte këtë.

28. Kërkesat nr. 20062 dhe 44393 kanë të bëjnë me të njëjtën pronë. Kërkesa nr. 20062 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, pra bashkëshortit të saj, ndërsa kërkesa nr. 44393 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, pra nënës së tij. Të dy bartësit e pretenduar të së drejtës pronësore kanë qenë bashkëpronarët të pronës së kërkuar, megjithatë, ata të dy e pranojnë se prona është shitur në vitin 2009. Paraqitësi i kërkesës nuk i tërhoqi kërkesat.

29. Kërkesat nr. 24235 dhe 24236 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pranon se pronat i janë shitur palës përgjegjëse në vitin 2007, megjithatë, ajo pretendon se pala përgjegjëse nuk e lejon atë që të shfrytëzojë një rrugë të përbashkët që kalon nëpër parcelën e kërkuar. Komisioni konsideron se, për aq sa që paraqitësi i kërkesës kërkon vërtetimin e të drejtës së saj për të shfrytëzuar rrugën e përbashkët, humbja e pretenduar e paraqitësit të kërkesës nuk mund të konsiderohet se ndërlidhet ose rezulton nga konflikti i vitit 1998-99.

30. Kërkesa nr. 26018 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra babait të tij. Paraqitësi i kërkesës pranon se prona e kërkuar është shitur kohët e fundit, por ai nuk e tërhoqi kërkesën. Komisioni vëren se prona e kërkuar është i regjistruar në regjistrat kadastrale në emër të palës përgjegjëse.

31. Kërkesa nr. 37510 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare së bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra vjehrrit të saj. Pala përgjegjëse, e cila është aktualisht e posedon pronën deklaron, se e bleu pronën e kërkuar nga vjehrrit i paraqitësit të kërkesës në vitin 2008 dhe paraqiti një kontratë shitje midis tij dhe vjehrrit të paraqitësit të kërkesës në mbështetje të deklaratës së tij. Kur u përball me deklaratën e palës përgjegjëse, paraqitësi i kërkesës pranoi se vjehrrit e saj, bartësi i pretenduari së drejtës pronësore ia kishte shitur palës përgjegjëse pronën e kërkuar në vitin 2008. Komisioni vëren se prona e kërkuar është e regjistruar në regjistrat kadastrale në emër të palës përgjegjëse.

3. Tjetërsimi vullnetar ose aftësia për të ushtruar të drejtën pronësore: Kërkesat nr. 01001, 01002, 01003 dhe 91701

32. Kërkesat nr. 01001, 01002, 01003 dhe 91701 janë parashtruar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaron se babai ka bërë kontratë blerje me palën përgjegjëse në vitin 2000 në lidhje me pronën e kërkuar, megjithatë, ajo pohon se babai i saj nuk e ka bërë marrëveshjen me vullnet të lirë, por se ishte nën presionin e palës përgjegjëse që të nënshkruante kontratën. Ajo pohon gjithashtu se çmimi i blerjes prej 120 000 DM, ishte nën vlerën e tregut dhe se çmimi i blerjes nuk është paguar tërësisht. Paraqitësi i kërkesës kërkon një vendim që të urdhërojë palën përgjegjëse për të paguar çmimin e papaguar të blerjes ose të anulojë kontratën dhe miratojë riposëdimin e pronës së kërkuar.

33. Pala përgjegjëse pohon se i bleu pronat e kërkuara në vitin 2000 dhe se transaksioni është bazuar në vullnetin e lirë të dy palëve. Sipas palës përgjegjëse, kontrata e blerjes është vërtetuar në gjykatë më 12 shkurt 2002 dhe se çmimi i blerjes është paguar plotësisht në ditën kur është nënshkruar kontrata. Prona e kërkuar është e regjistruar në regjistrat kadastrale në emër të palës përgjegjëse.

34. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka depozituar më parë një kërkesë në Drejtoratin për Çështje Banesore e Pronësore për një parcelë të ndërlidhur që është përfshirë edhe në kontratën e lartpërmendur të blerjes. Komisioni për Kërkesa Banesore e Pronësore në vendimin e tij nr. HPCC/D/74/2003/C datë 11 prill 2003 e hodhi poshtë kërkesën dhe ia referoi atë gjykatës lokale kompetente mbi bazën se çështja e rishikimit të kushteve të kontratës së shitjes sa i përket çmimit të tregut bie jashtë juridiksionit të saj.

35. Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të ofrojë dëshmi bindëse se babai i paraqitësit të kërkesës ka nënshkruar kontratën nën kërcënim. Në bazë të nenit 4.3 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007 / 5 me kërcënim supozohet nëse vlera e tregut e pronës në kohën e shitjes nuk ka lidhje të arsyeshme me çmimin aktual të blerjes. Në rastin konkret, nuk vërehet mospërputhje e tillë mes vlerës së tregut në kohën e shitjes dhe çmimit aktual të blerjes prej 12 0 000 DM.

4. *Kërkesat nr. 23466 dhe 47551.*

36. Kërkesa nr. 23466 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në emër të vëllait të gjyshit të saj. Kërkesa nr. 47551 është depozituar nga i njëjti paraqitës i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore.

37. Pala përgjegjëse Sevdajet Sadriu iu përgjigj kërkesave në emër të vëllait të tij, Behxhet Sadriu i cili aktualisht banon në Gjermani. Pala përgjegjëse pretendon se Behxhet Sadriu i ka blerë pronat e kërkuara nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2008.

38. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka depozituar disa dokumente që lidhen me të drejtën e pretenduar pronësore, pra fletët poseduese nr. 32 dhe 121 të cilat e tregojnë Ratimir Steviç si pronar të pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës ka depozituar edhe dy vendime trashëgimie të lëshuara nga Gjykata Komunale në Podujevë të vitit 1984 dhe 1989 të cilat tregojnë se Dragoljub Steviç ka trashëguar ½ e pronës që i përkiste vëllait të tij Ratimir Steviç. Sekretaria Ekzekutive i ka verifikuar të gjitha dokumentet e lartpërmendura kundrejt regjistrave kadastrale dhe regjistrave të mbajtur në Gjykatën Komunale në Podujevë. Paraqitësi i kërkesës ka depozituar edhe një vendim trashëgimie të lëshuar nga Gjykata e Kurshumlisë në Serbi me anë të secilës ajo ka trashëguar 1 / 10 e pronave të gjyshit të saj. Megjithatë, ky vendim trashëgimie nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm sepse Dragoljub Steviç vdiq në Revuce në Podujevë dhe Gjykata e Kurshumlisë nuk ka pasur kompetencën e duhur për t'u marrë me procedurat e trashëgimisë.

39. Paraqitësi i kërkesës konfirmon se e ajo dhe familja e saj kanë bërë një transaksion me Behxhet Sadriun, vëllain e të palës përgjegjëse në vitin 2008 për shitjen e parcelave të kërkuara. Megjithatë ajo pohon se transaksioni nuk u përfundua sepse pjesa e fundit të çmimit të blerjes nuk është paguar nga Behxhet Sadriu.

40. Pala përgjegjëse deklaron se vëllai i tij Behxhet Sadriu, ka nënshkruar një kontratë blerje me Zoran, Milutin dhe Mica Steviç më 4 janar 2008 për parcelat e kërkuara me çmimin e blerjes prej 250 000 €. Milutin dhe Mice janë nipërit/mbesat e Dragoljubit dhe kushërinjtë e paraqitësi të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës konfirmon se i ka dhënë leje me gojë Milutinit dhe Mices për të shitur parcelat e kërkuara në emër të saj. Pala përgjegjëse deklaron se të gjithë shitësit ishin të pranishëm kur kontrata është nënshkruar dhe se shuma prej 200.000 € e çmimit të blerjes u është paguar atyre në kohë. Pjesa e mbetur e çmimit të blerjes duhej të paguhej brenda gjashtë muajve në të cilën kohë "trashëgimtarët" do të merrnin dokumentacionin e nevojshëm që vërtetonte pronësinë e tyre me anë të trashëgimisë. Duket që procedura e trashëgimisë të mos jetë mbaruar dhe pjesa e mbetur e çmimit të blerjes është e papaguar. Paraqitësi i kërkesës konfirmon se një shumë parash është paguar si pjesë e transaksionit të blerjes. Një kopje e kontratës së blerjes i është ofruar Sekretarinë Ekzekutive, por kontrata nuk ishte vërtetuar nga gjykata pasi procedura trashëgimore nuk është përfunduar.

41. Në mënyrë që të përmbushen kriteret për konfirmimin e pronësisë nga ana e Komisionit, siç është përcaktuar në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me ligjin nr 03/L-079, paraqitësit e kërkesave duhet të dëshmojnë se kërkesa ndërlihet me konfliktin në kuptimin që ajo përfshin rrethanat që lidhen drejtpërdrejtë ose që rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-99. Kjo nuk është demonstruar nga paraqitësi i kërkesës në këto kërkesa, po ashtu paraqitësi i kërkesës nuk ka treguar që ka pasur humbje të posedimit ose pamundësi për të ushtruar të drejtat e pronësisë për

shkak të konfliktit. Në të vërtetë paraqitësi i kërkesës ka ushtruar, apo synuar të ushtrojë të drejtat pronësore për parcelat e kërkuara. Paraqitësi i kërkesës ka synuar që t'ja shesë palës përgjegjëse disa prej parcelave të gjyshit të saj. Ndonëse Komisioni nuk vendos për trashëgiminë e pretenduar nga paraqitësi i kërkesave për pronat e kërkuara nga bartësi i ndjerë i së drejtës pronësore, nuk ka asnjë dëshmi për ndonjë pengesë për ushtrimin e saj të të drejtave pronësore. Pengesa kryesore duket të jetë mungesa e procedurës trashëgimore të përfunduar që çon në konfuzion se kush janë trashëgimtarët e ligjshëm të pronave dhe cilët persona kanë zotësi juridike për të shitur parcelat e tokës. Pasi nuk ka asnjë provë për humbje të posedimit lidhur me konfliktin ose paaftësi për të ushtruar të drejtat e pronësisë për pronat e kërkuara, kërkesat e paraqitësit të kërkesave duhet të hidhen poshtë pasi bien jashtë juridiksionit të Komisionit

5. Tjetërsimi vullnetar ose aftësia për të ushtruar të drejtën pronësore: Kërkesat nr. 53998.

42. Kërkesa nr. 53998 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pra i biri i bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Ai kërkon riposedimin dhe konfirmimin e të drejtave të pronësore për pronën e kërkuar. Janë dy palë përgjegjëse në këtë kërkesë. Pala e parë përgjegjëse pretendon se fillimisht prona e kërkuar ishte në pronësi të familjes së tij deri në vitin 1953 dhe shpreh dëshirën për ta blerë pronën. Pala e dytë përgjegjëse pohon se e ka blerë pronën nga bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore në vitin 2009.

43. Paraqitësi i kërkesës dhe bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore pranojnë se nënshkruan një parakontratë shitje me palën e dytë përgjegjëse, por pretendojnë se kjo kontratë nuk u realizua pasi vetëm një pjesë e çmimit të blerjes është paguar. Paraqitësi i kërkesës kërkon riposedimin dhe anulimin e kontratës së shitjes. Komisioni konsideron se kërkesa e paraqitësit të kërkesës ka të bëjë me kontest kontraktual dhe nuk lind nga rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo si rezultat i konfliktit të vitit 1998-99. Rrjedhimisht ajo duhet të hidhet poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit.

6. Res judicata

44. Kërkesës nr. 18320 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka parashtruar edhe kërkesën nr. 18319, ku kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin për të njëjtën pronë si në kërkesën nr. 18320. Kërkesa nr 18319 është miratuar nga Komisionit me vendimin KPCC/D/A/92/2010 më 28 tetor 2010. Komisioni konsideron se vendimi i mëparshëm në të njëjtën çështje përbën *res judicata*, dhe për rrjedhojë kërkesa nr. 18320, duhet të hidhet poshtë.

45. Kërkesës nr. 30698 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra babait të tij. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar edhe një kërkesë tjetër, kërkesën nr. 19217 ku kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e së njëjtës pronë si në kërkesën nr. 30698. Kërkesa nr. 19217 është miratuar nga Komisioni me vendimin KPCC/D/A/92/2010 të datës 28 tetor 2010. Komisioni konsideron se vendimi i mëparshëm në të njëjtën çështje përbën *res judicata*, dhe për rrjedhojë kërkesa nr. 30698 duhet të hidhet poshtë.

46. Kërkesat nr. 36636 dhe 36659 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra babait të i tij. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar edhe një kërkesë tjetër, kërkesën nr. 36662 ku kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin për të njëjtën pronë si në kërkesën nr. 36636 dhe 36659. Kërkesa nr. 36662 është miratuar nga Komisioni me vendimin grupor KPCC/D/A/92/2010 të datës 28 tetor 2010. Komisioni konsideron se vendimi i mëparshëm në të njëjtën çështje përbën *res judicata*, dhe për rrjedhojë kërkesat nr. 36636 dhe 36659 duhet te hidhen poshtë.

47. Komisioni konstaton se të gjitha kërkesat e përmendura në seksionin B duhet te hidhen poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit, për arsyet e lartpërmendura.

C. Kërkesa të refuzuara.

48. Në bazë të nenit 8.6 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës, ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për drejtat e tyre pronësore dhe të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

49. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e depozituara nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

1. *Tjetërsimi vullnetar – mungesa e pronësisë: Kërkesat nr. 23407, 23408, 23409, 23410, 23411, 23412, 23413, 23414, 40985, 40987, 40988, 40989, 40990 dhe 40991*

50. Këto kërkesa janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Në kërkesat nr. 23407, 23408, 23409, 23410, 23411, 23412, 23413, 40987, 40988 dhe 40989 paraqitësi i kërkesës pranon se ai i ka shitur pronat e kërkuara tek Latif Sulkajt ("pala e parë përgjegjëse") në vitin 1984 ose 1985, megjithatë, ai pretendon se pala e parë përgjegjëse nuk ka paguar tërësisht çmimin e blerjes. Pala e parë përgjegjëse deklaron se ka qenë në posedim të pashqetësuar të pronës që nga viti 1985. Paraqitësi i kërkesës i kërkon Komisionit që të urdhërojë palën e parë përgjegjëse të paguajë çmimin e blerjes, duke përfshirë tërë interesin e akumuluar ose riposedimin e pronave të kërkuara. Gjatë përpunimit të

kërkesës, i biri i paraqitësit të kërkesës e informoi Sekretarinë Ekzekutive se paraqitësi i kërkesës ka vdekur. Djali i paraqitësit të kërkesës konfirmoi gjithashtu se paraqitësi i kërkesës dhe familja e tij nuk e kishin shfrytëzuar pronën e kërkuar që nga viti 1983-1984.

51. Në kërkesat nr. 23414, 40990 dhe 40991 pronat e kërkuara janë uzurpuar nga Rexhë Brahimaj ("pala e dytë përgjegjëse"). Pala e dytë përgjegjëse pretendon se pala e parë përgjegjëse ia ka transferuar atij pronësinë e këtyre pronave më 1985-1986 në këmbim të parcelave në pronësinë e tij. Më pas, djali i paraqitësit të kërkesës i konfirmoi Sekretarisë Ekzekutive se prona e kërkuar ishte shitur.

52. Në kërkesën nr. 40985 prona e kërkuar është e uzurpuar nga Lah Loshi ("pala e tretë përgjegjëse"). Pala e tretë përgjegjëse kërkon të drejtën ligjore për pronën e kërkuar, por nuk e specifikon të drejtën e tij pronësore të pretenduar dhe nuk ka depozituar asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij.

53. Provat para Komisionit tregojnë se ka një kontest në lidhje me pronat e kërkuara në pritje për gjykim para gjykatave vendore dhe se procedimi përkatës për këto kërkesa është iniciuar para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/5. Megjithatë, me provat në dispozicion të ofrura nga palët dhe të gjetura *ex officio*, Komisioni nuk është në gjendje arrijë në përfundimin nëse procedimi gjyqësor përfshin të gjitha pronat e kërkuara, dhe nëse ai ndërlidhet vetëm me pagesën e çmimit të papaguar të blerjes si pretendohet nga paraqitësi i kërkesës apo edhe me konfirmimin e pronësisë.

54. Pasi paraqitësi i kërkesës pranon se i ka tjetërsuar pronat e kërkuara vullnetarisht në fillim të viteve 1980, kërkesa duhet të refuzohet.

2. Tjetërsimi vullnetar – mungesa e pronësisë: Kërkesa të tjera.

55. Kërkesa nr. 26420 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra babait të tij. Fillimisht Paraqitësi i kërkesës pohoi se e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar në qershor 1999, megjithatë, më vonë konfirmoi se prona i është shitur palës përgjegjëse në vitin 1990. Pala përgjegjëse pretendoi se është pronar i pronës së kërkuar duke pohuar se e ka blerë pronën nga paraqitësi i kërkesës në vitin 1990. Paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

56. Kërkesat nr. 38961 dhe 38962 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra gjyshit të tij. Ai kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe posedimin. Pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën duke thënë se babai i tij e kishte blerë pronën e kërkuar nga gjyshi i paraqitësit të kërkesës në vitin 1970. Ky transaksion u konfirmua më pas nga paraqitësi i kërkesës, megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk i tërhoqi kërkesat.

57. Kërkesa nr. 13508 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe posedimit për pronën e kërkuar. Djali i palës përgjegjëse pretendon se babai i tij e ka blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në vitin 1997. Pasi paraqitësi i kërkesës vdiq në vitin 2007, pas paraqitjes së kërkesës, Sekretaria Ekzekutive kontaktoi djalin e paraqitësit të kërkesës. Ai konfirmoi se prona është shitur dhe u shpreh se ai nuk është më e interesuar në ndjekjen e kërkesës. Megjithatë, ai nuk e tërhoqi kërkesën.

58. Kërkesa nr. 24661 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra babait të tij. Pala përgjegjëse deklaron se babai i tij e ka blerë pronën 45 vjet më parë nga babai i paraqitësit të kërkesës dhe ai dhe familja e tij e kanë shfrytëzuar pronën e kërkuar që nga ajo kohë. Më pas, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se babai i tij në të vërtetë ia kishte shitur pronën shumë vite më parë familjes së palës përgjegjëse. Megjithatë paraqitësi i kërkesës nuk e tërhoqi kërkesën.

59. Kërkesa nr. 11441 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra gjyshit të tij. Paraqitësi i kërkesës kërkon riposelimin e pronës së kërkuar mbi bazën se pala përgjegjëse nuk e ka paguar plotësisht çmimin e blerjes.

60. Kërkesa nr. 25119 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra bashkëshortit të saj. Pala përgjegjëse deklaron se babai i tij e bleu ngastrën e kërkuar nga familja e paraqitësit të kërkesës në vitin 1986. Paraqitësi i kërkesës fillimisht kërkoj riposelimin e pronës, por më vonë konfirmoi se prona e kërkuar i ishte shitur familjes të palës përgjegjëse në vitin 1986 me anë të një transaksioni jozyrtar. Megjithatë, ajo nuk e tërhoqi kërkesën.

61. Kërkesa nr. 26270 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pra babait të tij. Pala përgjegjëse deklaron se e ka blerë pronën e kërkuar 20 vjet më parë nga një farë Miladin Markovic. Paraqitësi i kërkesës më pas pranoi se babai i tij ia kishte shitur pronën e kërkuar shumë vite më parë fqinjit të tij Miladin Markovic, por transaksioni nuk është reflektuar në të dhënat kadastrale.

3. *Kërkesa nr. 26806*

62. Kërkesa nr. 26806 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, pra si bashkëpronar i pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës paraqitësi i kërkesës ka depozituar një vendim trashëgimie të lëshuar nga Gjykata Komunale në Vernjacka Banja i datës 12 mars 1996. Megjithatë, vendimi në fjalë nuk e përmend parcelën e kërkuar, e cila u gjet e regjistruar në emër të babait të paraqitësit të kërkesës.

63. Sekretaria Ekzekutive ka kontaktuar disa herë paraqitësin e kërkesës për të kërkuar sqarime në lidhje me mospërputhjen, por ajo nuk pranoi të bashkëpunonte me Sekretariatën Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ajo nuk ka ndonjë pronë në Kosovë dhe kërkoj që Sekretaria Ekzekutive të ndërpresë përpunimin e kërkesës, megjithatë, ajo nuk e tërhoqi kërkesën.

4. *Kërkesat nr. 14550, 14551, 14552 dhe 14553*

64. Kërkesat nr. 14550, 14551, 14552 dhe 14553 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, pra si bashkëpronar së bashku me vëllezërit e motrat e saj. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposelimin e pronave të kërkuara. Në mbështetje të pretendimeve të saj, ajo ka depozituar një vendim të gjykatës nga Gjykata e Qarkut në Pejë, i datës 1 korrik 1999,

të lëshuar nga gjykata paralele në Leskovc, i cili synon të konfirmojë bashkëpronësinë e paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar.

65. Pala përgjegjëse, Shefqet Dreshaj, pohon se e ka blerë pronën e kërkuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Në mbështetje të pretendimeve, ai ka depozituar një kontratë shitje të aksioneve me "Fermën e gjedhëve Ndërmarrje e re" në Vrellë lidhur midis Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në emër të NSH "Dubrava" dhe vëllait të palës përgjegjëse Gani Dreshaj. Pala përgjegjëse më tej ka ofruar një deklaratë për transferimin dhe një Certifikatë për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme e regjistruar në emër të Gani Dreshajt me kontratë qiraje 99 vjet për pronën shoqërore.

66. Bazuar në provat para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën e pronësisë ose posedimit për pronat e kërkuara para ose gjatë kohës së konfliktit në vitet 1998-1999.

5. *Kërkesat nr. 53756 dhe 53758*

67. Kërkesat nr. 53756 dhe 53758 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, pra bashkëpronarit të pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës fillimisht kërkoi konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronave.

68. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 53756 deklaron se e ka blerë pronën 30 vjet më parë. Përfaqësuesi i autorizuar i palës përgjegjëse në kërkesën nr. 53758 ka depozituar një sërë dokumentesh, megjithatë, këto nuk ndërlidhen me parcelën e kërkuar ose asnjë parcelë nuk është identifikuar në dokumentet e tilla. Pas pretendimeve të palës përgjegjëse, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ajo i kishte shitur disa prej parcelave, por nuk ishte e gatshme të ofronte informacion të mëtejshëm. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës nuk i tërhoqi kërkesat.

69. Bazuar në provat para tij, Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë të drejtën e pronësisë ose posedimit për pronat e kërkuara para ose gjatë kohës së konfliktit në vitet 1998-1999.

6. *Kërkesat nr. 15123 dhe 40246*

70. Kërkesat nr. 15123 dhe 40246 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, pra bashkëpronarit të pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës kërkon riposedimin dhe konfirmimin e pronësisë për pronat. Të dyja kërkesat janë depozituar për të njëjtën parcelë. Gjatë procesit të verifikimit, Sekretaria Ekzekutive ka konstatuar se prona e kërkuar është regjistruar si pronësi shoqërore.

71. Pala përgjegjëse, i cili po shfrytëzon pronën, pretendon se e bleu pronën e kërkuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit gjatë procesit të privatizimit. Paraqitësi i kërkesës është kontaktuar sërish dhe deklaroi se ishte në dijeni se kjo parcelë është privatizuar dhe se ajo nuk kërkon më asnjë të drejtë ligjore për të. Megjithatë, ajo nuk i tërhoqi kërkesat.

72. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë seksion C, fillimisht paraqitësit e kërkesës pohuan se ata apo familjet e tyre kishin humbur pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999. Megjithatë, më vonë paraqitësit e kërkesës e informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata apo familjet e tyre, sipas rastit, i kanë tjetërsuar pronat vullnetarisht para konfliktit 1998-1999, ose kanë dështuar për të treguar të drejtën pronësore për pronat e kërkuara para ose në kohën e konfliktit të vitit 1998-99. Kështu, të gjitha këto kërkesa duhet të refuzohen nga Komisioni për shkak se paraqitësit e kërkesave dështuan të dëshmojnë pronësinë për pronën e kërkuar në kohën përkatëse.

D. Kërkesa për kompensim.


73. Në kërkesat nr. 24661, 26806 dhe 40246 paraqitësit e kërkesave kërkojnë gjithashtu, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin fizik ose humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

F. Vërejtjet përmbledhëse

74. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

75. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

76. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave ose mbajtësve të së drejtës pronësore, sipas rastit për të kërkuar konfirmimin e te drejtave pronësore për pronat e kërkuara, para autoriteteve vendore kompetente të tilla si organet kadastrale ose gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA23407	KPA23408	KPA23409	KPA23410	KPA23411	KPA23412	KPA23413
KPA23414	KPA40985	KPA40987	KPA40988	KPA40989	KPA40990	KPA40991
KPA23466	KPA37510	KPA47551	KPA00042	KPA40100	KPA51723	KPA24235
KPA24236	KPA51761	KPA51764	KPA51765	KPA51771	KPA51772	KPA53998
KPA27409	KPA51808	KPA51811	KPA51812	KPA01001	KPA01002	KPA01003
KPA26018	KPA91701	KPA11721				

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA26270	KPA26420	KPA38961	KPA38962	KPA11441	KPA13508	KPA24661
KPA14550	KPA14551	KPA14552	KPA14553	KPA53756	KPA53758	KPA15123
KPA40246	KPA25119					

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA06328	KPA18320	KPA20062	KPA30698	KPA36636	KPA36659	KPA44393
KPA00237	KPA00889					

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA26806
